

VENDIM
Nr. 821, datë 19.12.2022

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SELENICË, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE BRATAJ, TË PASURISË NR. 490/48, ME VENDNDODHJE NË
ZONËN KADASTRALE 1265**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “j”, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Selenicë, për njësinë administrative Brataj, të pasurisë nr. 490/48, me vendndodhje në zonën kadastrale 1265, sipas formularit dhe planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur për interes vendor.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të miratuar me vendimin nr. 195, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Selenicë të Qarkut Vlorë”.

3. Bashkisë Selenicë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Selenicë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i
adastrale

Institucionit: Njësia Administrative Brataj, Bashkia Selenicë										
Fusha e përdorimit të Pronës: Interes Vendor										
Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeks i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës m ²	Nga Sip. Totale: Sa Nderetose (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi i drejtë përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	1265	490/48	Shesh	Fshati Brataj	8064 m ²	0	Interes Vendor	Bashkia Selenicë	Bashkia Selenicë	